




UNIVERSITETI "FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA "FEHMI AGANI"

Januar	13.03	2017	viti
Org.	Numër	Sasia	Vlera
01	155	4	



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT TË GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"

DHE

UNIVERSITETIT TË VLORËS
"ISMAIL QEMALI"

Mars 2017



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" i Republikës së Kosovës dhe Universiteti të Vlorës "Ismail Qemali", Republika e Shqipërisë do të bashkëpunojnë si më poshtë.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Të dy universitetet do të shkëmbejnë kuadro shkencor-mësimor, për të mbajtur mësim apo ligjërata të veçanta në të gjitha nivelet e studimeve; për të udhëhequr sipas nevojës kandidatë në studimet pasuniversitare, të masterit dhe të doktoraturës; për të bërë kërkime shkencore dhe për këmbim përvoja si dhe për të marrë pjesë në projekte shkencore e profesionale me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 2

Të dy universitetet do të shkëmbejnë së paku një herë në vit studentë të niveleve përkatëse për forcimin dhe avancimin e aktiviteteve mësimore-edukative, artistike dhe sportive, si dhe për afrimin e grupeve ose të shoqatave e unioneve të studentëve, si dhe në rast nevojë për njërën palë të bëhen dhe ushtrimet laboratorike, përvojë praktike etj.

Neni 3

Të dy universitetet do të ndërtojnë programe studimore të përbashkëta, do të përdorin programet përkatëse ekzistuese dhe do të këmbëjnë: planprograme mësimore, informacione shkencore, dokumentacione dhe publikime shkencore si dhe do të diskutojnë për çështjet e përgjithshme ose të veçanta për mbarëvajtjen e punës dhe të reformës së universiteteve.

Neni 4

Të dy universitetet do të ftojnë në mënyrë të ndërsjellë shkencëtarë dhe staf akademik me rastin e organizimit të seminareve, konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare si dhe të veprimtarive të tjera pedagogjike.

Neni 5

Të dy universitetet miratojnë shkrimin e teksteve universitare të përbashkëta si dhe të literaturës ndihmëse e informative shkencore për studime të veçanta.



Neni 6

Të dy universitetet do të ndihmojnë në pajisjen e ndërsjellë të bibliotekave përkatëse me literaturë shkencore e profesionale të botuar në universitetet përkatëse ose me literaturë tjetër.

Neni 7

Të dy universitetet janë dakord që të kontribuojnë në kualifikimin e stafeve akademike në fushat përkatëse sipas nevojës dhe marrëveshjes së veçantë midis të dyja palëve, duke pasur parasysh dispozitat në fuqi të vendeve përkatëse.

Neni 8

Të dy universitetet janë dakord që krahas shtëpive botuese universitare të shikojnë mundësinë e krijimit të një topografie apo filiali të përbashkët ose të shikohet mundësia e botimeve të përbashkëta me bashkëpunim.

Neni 9

Të dy universitetet janë dakord që bashkëpunimi i veçantë midis fakulteteve, departamenteve etj., të bëhet në bazë të kësaj marrëveshjeje nëpërmjet rektorateve të universiteteve përkatëse.

Neni 10

Të dy universitetet janë dakord që të ngrejnë një komision koordinator të përbërë prej katër anëtarësh. Secila palë përveç rektorit cakton edhe një anëtar përgjegjës për realizimin e marrëveshjes.

Neni 11

Të dy universitetet do të shkëmbejnë delegacionet e tyre një herë në vit për të vlerësuar rezultatet dhe aktivitetet shkencore të cilat parashikohen për periudhën e mëtejshme.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 12

Të dy palët mund të bëjnë me konsensus reciprok modifikime në këtë marrëveshje ose të shtojnë ndonjë aneks më të detajuar. Në qoftë se njëra palë heq dorë nga kjo marrëveshje, është e detyruar jo më vonë se tre (3) muaj të informojë me shkrim palën tjetër.



DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 13

Të dy universitetet janë të detyruar të marrin përsipër shpenzimet e qëndrimit (strehim, ushqim dhe ndihmë mjekësore) për palën e ftuar, si dhe transportin nga vija kufitare (pritje- përcjellje).

Neni 14

Numri i shkëmbimit të stafeve apo studentëve do të jetë reciprok dhe do të caktohet veçmas për secilin vit akademik.

Neni 15

Programet e qëndrimit të stafeve duhet t'i dërgohen universitetit tjetër jo më vonë se tre muaj para mbërritjes së stafeve në universitetin pritës, ndërsa informimi për realizimin e vizitës të bëhet dhjetë ditë para nisjes.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Kjo marrëveshje është e përpiluar dhe e nënshkruar në gjuhën shqipe në dy kopje dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy institucioneve.

UNIVERSITETI I GJAKOVËS

"Fehmi Agani"

R E K T O R I

Prof. Dr. Shaban Buza



UNIVERSITETI I VLORËS


"Ismail Qemali"

R E K T O R I

Prof. Roland Zisi



REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI



ABMS Prot.

Tiranë, më 30.12.2016
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: FTESË PËR BASHKËPUNIM

DREJTUAR: UNIVERSITETIT TË TIRANËS

UNIVERSITETIT POLITEKNIK, TIRANË

UNIVERSITETIT BUJQËSOR, TIRANË

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE, TIRANË

UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN

UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE ✓

AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA

AKADEMISË SË SIGURISË

**SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "NEW YORK
UNIVERSITY – TIRANA"**

**KODRA E DIELLIT
TIRANË**

**SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "LUARASHI"
RRUGA E ELBASANIT, ND. 59, H. 1, KODI POSTAR 1010
TIRANË**

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BULEVARDI "11 BELLIN" NR. 1
TIRANË**



SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "ZEMIRA
KËSHILLIT TË MIRË"
RRUGA E DURRËSIT, KOMPLEKSI SPITALOR UNIVERSITAR
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË JOPUBLIKE "MARUBI"
RRUGA "ALEKSANDËR MOISIU", NR. 76, 1005
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "UNIVERSITETI
"MARIN BARLETI"
RRUGA "SAMI FRASHËRI", NR. 41
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "UNIVERSITETI
EUROPIAN I TIRANËS"
BULEVARDI "GJERGJ FISHTA", ND. 70, H 1 (ISH NPY NR. 2)
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "WISDOM
UNIVERSITY"
RRUGA "MEDAR SHTYLLA", KOMUNA E PARISIT
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "ALDENT"
RRUGA E DIBRËS, NR. 235
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "UNIVERSITETI
POLIS"
AUTOSTRADA TIRANË - DURRËS, KM 5, KASHAR, KP 2995
TIRANË

INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË "SHKOLLA E LARTË
"EPOKA"
AUTOSTRADA TIRANË - RINAS, KM 12,
TIRANË

INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË "SHKOLLA E LARTË
"NEHEMIA"
BUÇIMAS, POGRADEÇ

INSTITUCIONIT "SHKOLLA E LARTË TË
SHQIPËRISË"
BULEVARDI "GJERGJ FISHTA", NR. 70, H 1



SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "PAVARËSIA"
RRUGA E SKELËS, P.O. BOX 4358 AL-9401
VLORE

SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "LOGOS"
RRUGA "DRITAN HOXHA", PALLATET "KOMFORT"
TIRANË

SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË "UNIVERSITETI
METROPOLITAN TIRANA"
RRUGA "BRIGADA VIII"
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "TIRANA BUSINESS UNIVERSITY"
RRUGA E KAVAJËS, ISH PARKU I AUTOBUSAVE
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "HËNA E PLOTË" (BEDËR)
RRUGA "JORDAN MISJA", KOMPLEKSI USLUGA
TIRANË

AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA "REALD"
LAGJA "24 MAJ", PRANË STACIONIT TË TRENIT
VLORE

AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT
RRUGA "VANGJEL NOTI", NR. 25 (PËRBALLË "AMC"), LAPRAKË
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE "INSTITUTI
KANADEZ I TEKNOLOGJISË"
RRUGA "SULEJMAN DELVINA", ZAYED CENTER
TIRANË

INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË PRIVAT "KOLEGJI
PROFESIONAL I TIRANËS",
NJËSIA BASHKIAKE, NR. 4, RRUGA "XHANFIZE KEKO"
KOMPLEKSI "XHURA"
TIRANË

SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE SEVASTI
PARASHQEV I QIRIAZI
KODËR - KUMZË
TIRANË



KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT "VOCAL ADVANT &
PARTNERS"
RRUGA "PROKOP MYZEQARI", P/90/1
TIRANË

Të nderuar rektorë,

Në kuadër të hartimit të Dokumentit Strategjik "Plani Kombëtar kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit", nga Këshilli i Ministrave, kërkohet kontributi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), lidhur me analizimin e situatës dhe hartimin e planeve përkatëse të veprimit, në institucionet shkollore të arsimit parauniversitar dhe në institucionet e arsimit të lartë.

Lidhur me sa më sipër, do të ishte i mirëpritur kontributi i institucioneve të arsimit të lartë që ju drejtoni, në bashkëpunim dhe me forumet e studentëve, lidhur me përgatitjen e një raporti mbi vlerësimin e situatës/përmasës eventuale të përdorimit të kanabisit nga studentët si dhe planifikimin e veprimtarive parandaluese që mund të realizohen nga IAL, si dhe përcjelljen e tij në MAS brenda datës 31.01.2017.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë, më06.01.2014

Lënda: Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës ne fuqi:

Drejtuar:

- **Zv. Rektor** ✓
- Kancelar
- **Dr. Aurela Saliaj** Dekan F. Sh. P.
Kryesekretare F. Sh. P.
- **Prof. Dr. Albert Qarri** Dekan F. E.
Kryesekretare F. E.
- **Prof. Asoc. Aleks Trushaj** Dekan F. Sh. H.
Kryesekretare F. Sh. H.
- **Prof. Asoc. Hajdar Kicaj** Dekan F. Sh. T.
Kryesekretare F. Sh. T.
- **Spektori i Burimeve Njerëzore**
- Drejtoria e Financës Dhe Buxhetit
- **Spektori Juridik**
- Spektori i Shërbimeve Blerjeve dhe Mirëmbajtjes
- **Drejtoria e Komunikimit**
- Zyra e Projekteve, Investimeve dhe Aktiviteteve Shkencore
- **Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë**
- Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë
- **Njesia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit**
- Spektori i Bibliotekave
- **Qendra Long Life Learning**
- Spektori I Kurrikulave dhe Informimit të Studentëve ✓

Rektori
Prof. Dr. Roland Zisi

